logo Image not found or type unknown

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Constitutional Articles: Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë

### Constitutional Paragraph: 38 para 2

Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.

**Instrumentet ndërkombëtare Nenet**

No results

| Ligjet | Nenet |
| --- | --- |
| Ligji nr. 06/l- 026 për azil<br>Ligji nr. 06/l- 026 për azil | Neni 32<br>**E drejta e mendimit dhe besimit fetar dhe lirinë e fesë**<br>Qeveria e Kosovës do t'iu garantojë aplikuesve të drejtën e ushtrimit dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre. |
| Ligji nr. 06/l- 026 për azil<br>Ligji nr. 06/l- 026 për azil | Neni 42<br>**Liria e mendimit dhe besimit fetar**<br>Qeveria e Kosovës do t'i garantojë personit me status refugjati apo personit me status të mbrojtjes plotësuese të drejtën e ushtrimit, lirinë e mendimit dhe besimit fetar sipas bindjeve të tyre |

**Ligjet**

**Nenet**

Ligji nr. 06/l- 026 për azil
Ligji nr. 06/l- 026 për azil

Neni 69

**Revokimi, anulimi apo refuzimi i ripërtëritjes së statusit të refugjatit**

1. Organi kompetent do ta revokojë, ose refuzojë ripërtëritjen e statusit të refugjatit në rastet kur:

1.1. ai apo ajo ka pushuar të jetë refugjat në pajtim me nenin 68 të këtij ligji;

1.2. ai apo ajo ka qenë apo është përjashtuar nga të qenit refugjat në pajtim me nenin 8 të këtij ligji.

4. Personit të cilit i është revokuar statusi i refugjatit në bazë të nën-paragrafit 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni, dhe i cili është prezent në Republikën e Kosovës do t'i garantohen të drejtat si në vijim: e drejta për mos diskriminim, e drejta për liri fetare, qasja në gjykata, edukim, mos dënimi për shkak të hyrjes apo qëndrimit ilegal, respektimin e parimit të moskthimit.

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS
Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS

Neni 36

**Preliminaret (Çështjet paraprake)**

Personat që dëshirojnë të lidhin martesë në pajtim me rregullat fetare (religjioze) nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë, përderisa ata nuk e dëshmojnë lidhjen e martesës ligjore me çertifikatë të lëshuar nga regjistri i ofiqarit.

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS
Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS

Neni 37

**Dokumentacioni**

(1) Zyrtari nga bashkësia religjioze, përpara të cilit është lidhur martesa sipas rregullave fetare, i dërgon ofiqarit dokumentin e nënshkruar nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nga përfaqësuesi i bashkësisë fetare, duke e dokumentuar me këtë lidhjen e martesës.

| **Ligjet** | **Nenet** |
|---|---|
| Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS<br>Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS | Neni 38<br><br>**Regjistrimi**<br><br>(1) Ofiqari është i detyruar që të regjistrojë martesën e lidhur në mënyrë religjioze brenda tri ditësh pas pranimit të dokumentit të paraparë në këtë Ligj.<br><br>(2) Menjëherë pas regjistrimit të martesës religjioze në librin amëz të të kurorëzuarve, ofiqari do të lëshojë çertifikatën e martesës fetare (religjioze). |
| Fshi LIGJI NR. 04/L-149<br>LIGJI NR. 04/L-149 | Neni 32<br><br>**Rendi shtëpiak**<br><br>1. Me aktin nënligjor për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese (më tej: akti për rendin shtëpiak), të cilin e nxjerrë Ministri, rregullohet organizimi dhe mënyra e jetës së personave të dënuar dhe të personave të paraburgosur, e në veçanti:<br><br>1.4. mënyra e plotësimit të nevojave fetare; |
| Fshi LIGJI NR. 04/L-149<br>LIGJI NR. 04/L-149 | Neni 89<br><br>**E drejta për ushtrimin e fesë**<br><br>1. Personi i dënuar ka të drejtë të marrë pjesë në ceremoni fetare dhe të lexojë literaturë fetare.<br><br>2. E drejta për t'u vizituar nga përfaqësuesi kompetent i fesë përkatëse nuk mund të kufizohet. Koha e vizitave përcaktohet me aktin për rendin shtëpiak.<br><br>3. Me kërkesë të personave të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të caktojë vizita të rregullta të përfaqësuesit kompetent të fesë përkatëse në institucionin korrektues, nëse numri i personave të dënuar të të njëjtit besim fetar e arsyeton këtë.<br><br>4. Drejtori i institucionit korrektues përkohësisht mund t'i përjashtojë personat e dënuar nga ceremonitë fetare, nëse përjashtimi i tillë është i nevojshëm për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe lidhur me këtë njoftohet përfaqësuesi kompetent i fesë.<br><br>5. Ceremonitë fetare mbahen në lokale të veçanta të përshtatshme të institucionit korrektues. |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT<br>LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT | Neni 7.1<br><br>**Qasja në Gjykata**<br><br>1. Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, gjendjes sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. |
| Ligji Nr. 02/L-31 PËR LIRINË FETARE NË KOSOVË<br>Ligji Nr. 02/L-31 PËR LIRINË FETARE NË KOSOVË | Neni 1<br><br>**Liria Fetare**<br><br>1.1. Çdo njëri ka të drejtë të gëzojë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetarë. Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur ose për të mos pasur fe, për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin, dhe lirinë për të manifestuar fenë ose besimin, qoftë si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive. |
| LIGJI Nr. 05/L -028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE<br>LIGJI Nr. 05/L -028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE | Neni 28<br><br>**Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik**<br><br>1. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit qe mbajnë regjistrime sipas paragrafit 5 të nenit 33, në formë të donacionit dhe sponsorisimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativoarsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij ligji konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut.<br><br>2. Një kontribut i lejueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t’i bëhet:<br><br>2.2.4. institucionet fetare; |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| LIGJI Nr. 04/L-046 PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS, LIGJI Nr. 04/L-046 PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS, | Neni 7<br><br>**Obligimet e RTK-së në lidhje me përmbajtjen, kanalet dhe shërbimet**<br><br>1. Obligimet e shërbimit publik të RTK-së në lidhje me përmbajtjen, kanalet dhe shërbimet që ofron ai në mënyrë të veçantë duhet të përfshijnë si vijon:<br><br>1.16. vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pozitës shoqërore dhe aktiviteteve të komuniteteve të regjistruara fetare. |
| LIGJI Nr. 04/L-046 PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS, LIGJI Nr. 04/L-046 PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS, | Neni 18<br><br>**Politika redaktuese dhe e përmbajtjeve programore**<br><br>4. RTK nuk do të transmetojë asnjë material, i cili me përmbajtjen, nëntekstin, dykuptimësinë, aludimin ose edhe me tonin, nxit diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. |

| **decisionTitle*** | **decisionDescription*** |
| --- | --- |
| Nuk ka rezultat | |